

4

OMA 4/1 Prot
Dt. 13.01.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 24/1 prot.

Shkodër, më 12.01.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 84, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 14, shkronja "f", neni 15, të ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, shkronja "a", pika 1.3, shkronja "c", neni 18, neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 54, shkronja "dh" dhe "k", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 4, neni 5, neni 6, shkronja b, ç dhe d, neni 7, pika 1, neni 39, neni 40, neni 41, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, neni 17, neni 32, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 1 prot., datë 04.01.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 23.12.2022", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit¹ te vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës & VKB Nr. 86, datë 23.12.2022 "Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023", me këto elementa:

1. Buxheti i Bashkisë Vau Dejës, ka burime buxhetore për vitin 2023 në vlerën totale prej 913.987 mijë lekë, nga ku transferata e pakushtëzuar është 267.764 mijë lekë, transferata e kushtëzuar është 358.161 mijë lekë, transferata e pakushtëzuar sektoriale është 118.044 mijë lekë (në të cilën përfshihen, fondet për konviktet e arsimit parauniversitar 9.077 mijë lekë, arsimit parashkollor, e detajuar personeli mësimor 42.501 mijë lekë, stafi mbështetës 1.047 mije lekë, arsimit parauniversitar 2.559 mije lekë, mbrojtja nga zjarri 13.972 mijë lekë, mbrojtja sociale 19.958 mijë lekë, administrimi i pyjeve 7.184 mijë lekë, rrugët

¹ I miratuar me 20 vota pro

6.306 mijë lekë, ujëtja dhe kullimi 13.240 mijë lekë, menaxhimin e mbetjeve urbane 2.200 mijë lekë.

2. Plani i të ardhurave për vitin 2023 është në vlerën 170.018 mijë lekë,
3. Fondi i të ardhurave të trashëguara 879.225 mijë lekë,
4. Fondi rezervë dhe kontigjencë për vitin 2023 është planifikuar në vlerën prej 500 mijë lekë ose 0.9% e buxhetit,
5. Investimet e planifikuara për vitin 2023 janë në vlerën prej 94.414 mijë lekë,
6. Numri i punonjësve për vitin 2023 është 388 punonjës,
7. Fondi për mbrojtjen civile (burimet e vetë bashkisë) dhe mbrojtjen nga zjarri për vitin 2023 është planifikuar në vlerën prej 41.204 mijë lekë ose 4.94% e buxhetit të vitit 2023,

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

